

DEKRET
Nr. 11742, datë 24.9.2020

**PËR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR
PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE
“VAKANCË E PARAKOHSHME”**

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179, pika 2, të Kushtetutës, neneve 7, pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh, pika 2, 86, pika 4, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi vlerësova njoftimin nr. 268 prot., datë 18.9.2020 dhe vendimin nr. 29, datë 16.9.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, administruar me nr. 3188 prot., datë 21.9.2020, nëpërmjet të cilit KED-ja ka vendosur njoftimin e Presidentit të Republikës për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur fillimisht nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10723, datë 7.2.2018, rishpallur me dekretin nr. 11291, datë 27.9.2019, për shkak se në përfundim të procedurave të verifikimit të ndjekura nga KED-ja, rezulton se në garë për plotësimin e këtij vendi vakant, aktualisht nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e “Vakancës së parakohshme” të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj.

Neni 2

Rishpallja e kësaj procedure aplikimi dhe publikimi i saj, sipas tekstit bashkëlidhur të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**